



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 104, Datë 22.04.2021

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 27, DATË 29.01.2021, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “AGETA” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “BORIE – LURE 1” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1800 KW”.**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 15, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 22.04.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 56/1 prot, datë 15.04.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 27, datë 29.01.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë “AGETA” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Borie Lure 1”, me kapacitet të instaluar 1800 kW,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 27, datë 29.01.2021, ndër të tjera ka vendosur:
  1. Të licencojë shoqërinë “AGETA” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Borie Lurë 1”, me kapacitet të instaluar 1800 kW, për një afat 30 vjeçar.
  2. Shoqëria të dokumentojë në ERE brenda 3-muajve miratimin/njoftimin nga MIE të shoqërisë AGETA sh.p.k. si përfaqësuese dhe zbatuese në vijim të Kontratës nr. 65 REP., nr. 38/1 KOL., datë 16.01.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Borie Lurë 1”, me kapacitet prodhues 1800 kW, në rrjedhën e përrenjve të kurorës së Lurës, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër, Qarku Dibër, pas tërheqjes/largimit të shoqërisë “BAJRAMI N”.
- Ne plotësim të kushtit të sipërcituar, shoqëria “AGETA” sh.p.k me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 32/5 prot., datë 13.04.2021, ka përcjellë një komunikim të MIE-s (e – mail datë 18.11.2020), nga i cili rezulton se kjo e fundit ka njohur shoqërinë “AGETA” sh.p.k si zbatuese të kontratës nr. 65 Rep., nr. 38/1 Kol, datë 16.01.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe

*administrimin e HEC-it Borie Lurë 1 me kapacitet prodhues 1.8 MW, në rrjedhën e përrenjve të Kurorës së Lurës, degë e Lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër, Qarku Dibër.”*

- Sa më sipër shoqëria “AGETA” sh.p.k., ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2, të Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27, datë 29.01.2021 “Mbi licencimin e shoqërisë “AGETA” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “BORIE Lurë 1”, me kapacitet të instaluar 1800 kW.”
- Me plotësimin e kushtit nga ana e shoqërisë, nuk ka më asnjë dokument i cili duhet t’i nënshtrohet procedurës së rinovimit, si referuar në konstatimet e vendimit të bordit të ERE nr. 27/2021 për licencimin e shoqërisë AGETA sh.p.k.. Aktualisht shoqëria rezulton me një dokumentacion të plotësuar tërësisht.
- Neni 113, i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë parashikon mundësinë e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Pikat 2 dhe 5, të vendimit Nr. 27, Datë 29.01.2021, shfuqizohen.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë subjektin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**